CREDINS bank

NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.

Për: Z/Znj._____(Aksioner/Perfaqesues/e i/e Aksionerit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Merkure datë 15.06.2016, ora 12.00 në ambientet e " BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do te zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Miratimi i Pasqyrave Financiare vjetore te "Banka Credins" sh.a per vitin 2015 sipas IFRS.

2. Miratimi i Pasqyrave Financiare vjetore te "Banka Credins" sh.a per vitin 2015 sipas kërkesave te Bankës se Shqipërisë

3. Miratimi i Rezultatit Financiar te "Banka Credins" sipas IFRS dhe Bankës se Shqipërisë sh.a per vitin 2015.

4. Propozim per miratimin e ekspertes kontabël te autorizuar Znj.Vera Fazlli Lala per vlerësimin e zmadhimit te kapitalit aksioner te shoqërisë "Banka Credins" Sh.a nëpërmjet kalimit te fitimit te pashpërndare te vitit 2015.

5. Propozim per riemërimin e shoqërisë "Ernst & Young" si ekspert kontabël i autorizuar per auditimin e pasqyrave financiare per vitin 2016.

6. Propozim per miratimin e emetimit te obligacioneve me kushtet e mëposhtme:

   a) Vlera totale e emetimit do të jetë 5.000.000 Euro dhe 1.000.000 USD.
   b) Vlera nominale e obligacioneve të jetë 10.000 Euro dhe 10.000 USD.
   c) Obligacionet e emetuara jane tituj borxhi qe përcaktojnë te drejtën e investitorit per te marrë ne datën e maturimit 100% te vleres nominale te investimit.
   d) Obligacionet e emetuara ne formen e borxhit te varur, nuk do të jenë të garantuara dhe nuk jane subjekt i nje garancie qe permireson prioritetin e pretendimeve sipas nenit 31 te Rregullores "Per kapitalin Rregullator te bankes" miratuar me vendim te Keshillit Mbikeqyres nr.69, date 18.12.2014, ndryshuar me vendim nr.19, date 04.03.2015 .
   e) Obligacionet e Bankes Credins do emetohen me "par value", me cmimin qe i korrespondon vleres nominale te cdo prerje obligacioni. Kjo do te thote qe çmimi i blerjes se tyre eshte i barabarte me 100% te vleres nominale. Shumat e obligacioneve jane me prerje minimale ne 10,000 (dhjete mije) euro dhe 10,000 (dhjete mije) Usd.
   f) Fondet nga shitja e obligacioneve do të përdoren nga emetuesi ne aktivitetin e ushtrimit të veprimtarisë së tij dhe veçanërisht ne dhënien e kredive të formave të ndryshme si edhe në investime karakteristike të këtij aktiviteti.
   g) Kohëzgjatja e obligacioneve të jetë 7 vjet. Ne baze Neni-t 39, kreu IV, i Rregullores se Bankes se Shqipërisë "Per Kapitalin Rregullator te Bankes", Banka e Shqiperise mund te jape miratimin paraprak bankes per te shlyer instrumentet e kapitalit te nivelit te pare dhe te dyte, perpara pese viteve nga data e emetimit te tyre, vetem kur jane plotesuar kushtet e parashikuara ne paragrafin e pare te Nenit 39, si dhe jane plotesuar kushtet e percaktuara ne shkronjen "a" dhe "b" te paragrafit te trete te ketij neni.

Banka Credins Sh.a
Nr. Licencën 16, Dt. 31.03.2003, NIPT K31608801O
Rruga "Vaso Pasha", Nr. 8, Tiranë, Shqipëri

SWIFT CODE: CDISALTR
http://www.bankacredins.com
e-mail: info@bankacredins.com

Tel: +355 4 2234 096, +355 4 5353 000
Fax: +355 4 2222 916
Cel: +355 69 20 69 666